



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.76/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Ymer Hoxha dhe Afiete Sada anëtarë, me zyrtares e lartë ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politi Samostalna Liberalna Stranka (SLS), me seli në Graçanicë, për shkak të vendosjes së materialit zgjedhor në hapësirat publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 07.06.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**Pranohet** si e bazuar ankesa e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) Prishtinë, dhe subjektit politi Samostalna Liberalna Stranka (SLS), me seli në Graçanicë, i shqiptohet dënimi më gjobë në vlerë prej 1.200.00 (njëmijë dyqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

### A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 05.06.2017, nga Institutit Demokratik të Kosovës KDI, me të cilën pretendon se gjatë monitorimit të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e parakohshme, më datën 04.06.2017, në Graçanicë në rrugën “Princi Lazar” ishin të vendosur postere të subjektit politi Samostalna Liberalna Stranka (SLS), në hapësirë publike përkatësisht transformator të energjisë elektrike.

Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së nenit 33 paragrafi 1 pika b e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, nga ana e SLS- në momentin që kanë vendosur posterat në hapësirë publike.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur një fotografi të printuar.

Në përgjigjen në ankesë të Samostalna Liberalna Stranka (SLS), të datës 06.06.2017, është e prinuar ankesa e parashtruar nga KDI, mirëpo vetëm ka të bashkangjitur një fotografi nga vendi i shkeljes së pretenduar në ankesë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

**Ankesa është e bazuar**

Nga fotografitë e ofruara si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se materiali zgjedhor i subjektit politik nga Samostalna Liberalna Stranka (SLS), janë të vendosura në ), në hapësirë publike përkatësisht transformator të energjisë elektrike, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33, pika b), të LZP-së e cila përcakton: “ *Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut*”.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase SLS kanë marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe për kundër të këtij fakti se materiali zgjedhor nga ky subjekt politik është vendosur në hapësira publike. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që se subjektit politik në fjalë, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre brenda afatit të caktuar shihet se kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes ashtu që kanë tërhequr materialin zgjedhor nga vendi i palejuar, edhe pse në përgjigje kanë ofruar vetëm një foto si dëshmi që kanë bërë përmirësimin e shkeljes, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr.76/2017 më datën 07.06.2017.



#### ***Këshilla Juridike:***

*Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.*